

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magistratëve/ Rama: Askush nuk e urdhëron legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën
ADRESA	https://www.cna.al/politike/pagat-e-magjistrateve-rama-askush-nuk-e-urdheron-legjislativ-in-se-kur-d-i474151
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:41:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d3518b9748b5710e951625a8f67fc173205efdadf8351477c85f0a05f0d41be7
TEKSTI	165e78ebe2c1ded89de3cc906d40340e151fd299a12d9d90382d13602c6e5213
PAMJA	7a923cf66f4fb545ae50a6bce074d608693c7c4f63e4bd15a71301bbfae763a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	efd41845be9923e42f791230647bf557c8e724c99bf82778d25dee4f923f6691
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/efd41845be9923e42f791230647bf557c8e724c99bf82778d25dee4f923f6691>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

19:36 Aktualitet


15 shtatori po pritet si një datë e një beteje të drejtësi...

Pagat e magjistratëve/ Rama: Askush nuk e urdhëron legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën



14 Shtator 2026, 19:29, Politikë CNA





Kryeministri Edi Rama ka bërë një tjetër reagim në rrjetet sociale lidhur me përplasjen për pagat e magistratëve. Në postimin e tij në "X", Rama shkruan se s'kush nuk e zëvendëson dot parlamentin dhe as nuk e urdhëron dot legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën.

Ai shton më tej se vetëm Gjykata Kushtetuese ka të drejtën të thotë se legjislativi mund të ketë bërë gabim por jo se si duhet të veprojë.

Ndër të tjera shprehet se nëse shoqatat e prokurorëve apo gjykatësve, do t'i imponohet qeverisë me kallëzime për çështjen e pagave të tyre, sipas tij kjo është një sfidë që nuk e shqetëson. Rama thotë se kjo nuk është çështje inati por "sfidë shtetbërjeje europiane e Shqipërisë".

"Në 17 shtator mbaron vetëm ky episod i tensionuar publikisht, që mund dhe duhet të ishte shmangur, por nuk shteron nevoja për të komunikuar mes pushteteve të pavarura", shprehet ndër të tjera kryeministri.

Reagimi i plotë:

"E pabesueshme, po e vërtetë që një gjykatës e kupton kështu pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar..."

Kurrë jo, kjo nuk është gjuhë gjykatësi, po gjuhë ultrasi që bërtet në rrugë kundër VAR-it.

Keqardhje dhe disa të vërteta të thjeshta:


Askush nuk e zëvendëson dot parlamentin dhe as nuk e urdhëron dot legjislativin se kur duhet ta ngrejë dorën. Vetëm Gjykata Kushtetuese e askush tjetër, ka të drejtën dhe detyrën t'i thotë se kur e ka ngritur dorën gabim, po as ajo vetë nuk i thotë dot kurrësi pushtetit të pavarur legjislativ se si duhet ta ngrejë dorën.

Politikën e pagave e propozon vetëm qeveria, e miraton vetëm parlamenti dhe e zbaton vetëm qeveria. Gjykata Kushtetuese ndërhyt vetëm nëse cënohet një parim a një normë kushtetuese, që ligjvënësit duhet ta riparojnë pa u cënuar në pavarësinë e tyre, siç e shohin ata të udhës të shprehen me votën e tyre.

Nëse largqoftë, shoqatat e prokurorëve e të gjykatësve kanë vendosur që me mjete politike dhe juridike të koordinuara me zyrat e prokurorive e të gjykatave si një ushtri e rreshtuar kundër qeverisë, të na imponohen me kallëzime, sigurime a përmbarime për të rritur pagat e tyre, atëherë jemi përpara një sfide të një lloji të ri, e cila nuk na tremb po na shqetëson pamasë. Por ne nuk duam të jetë kështu dhe unë nuk dua ta lejoj që të ndodhë kështu, sepse ndryshe nga si e mendon ky gjykatësi mediatik, kjo e pagave stratosferike, për ne nuk është çështje inati po sfidë shtetbërjeje europiane e Shqipërisë.

Është shumë e thjeshtë. Tryeza e përgatitur për takimin e kërkuar dhe të anuluar vazhdon të jetë gati. Në 17 shtator mbaron vetëm ky episod i tensionuar publikisht, që mund dhe duhet të ishte shmangur, por nuk shteron nevoja për të komunikuar mes pushteteve të pavarura. Përkundrazi, ajo nuk lindi nga episodi i pagave dhe do të jetë edhe më e madhe në çdo hap deri në anëtarësimin në Bashkimin Europian.

Por ne tryezën dhe gatishmërinë kemi, të tjerat janë në gjykimin e gjykatësve:-). /CNA





Të sugjeruara

Efektivi dhunoi protestuesin/ Këllici: Polic patronazhist ordiner

Çështja “KAYO” dhe akuzat për trafik armësh/ Opozita ngre pikëpyetje

“Blerja” e Gjykatës Kushtetuese/ 2 deputetët tregojnë planin e mazhorancës

“Sa u shkon paga?”/ Braçe me laps e letër për gjyqtarët, përplasjet me socialistët

Trafiku i armëve/ Berisha: Yeffet një Agasi i huaj, ndrikulla Puca prodhon autoblanda

Berisha tregon detaje nga vizita në SHBA

Balliu: Kayo nën hetim parlamentar, pyetjet për Ron Yeffet dhe rrethin e Ramës kërkojnë

pergjigje

Deputeti i PD-së: Të gjithë ministrat e Ramës janë thjesht kukulla

Berisha: Rreth 6 mijë nxënës më pak brenda vitit, alarm i madh demografik dhe arsimor

“Territorialja” në Elbasan/ Rama zbulon çfarë ndodh me Cërrikun, Belshin, Librazhdin dhe Prrenjasin

Ish-deputeti: Ngritja e Muzeut Hebraik në Vlorë po u bën nder shqiptarëve

Çmimi i naftës/ Braçe “godet” Ramën: Duhet të jesh pa sy e mendje për të mos kontrolluar taksat

"Nuk është qeska e tyre e buxhetit"/ Rama reagon sërish për pagat e gjyqtarëve

Konsultimet në Berat për “Territorialen”/ Zbardhet qëndrimi i Ramës

Akuzat për trafik armësh/ Këlliçi ngre pikëpyetjet: Pse gënjeu në Kuvend ministri Nufi?

Debate të forta në takimin e Ramës në Berat/ Banorët braktisin mbledhjen

Ja kur do të largohet Rama nga pushteti

"Marrëveshje me rrjetin universitar në Londër"/ Rama: Do të hapim 4 universitete të reja

Nis podcasti "Flasim"/ Rama: Rezultatet e PISA 2025, fryt i një pune të gjatë

"Paguhet 500 euro më shumë se sa kolegët në Greqi"/ Rama, reagim për pagat e gjyqtarëve

[editorial](#)

16:28 Editorial Elvi FUNDO

Edhe një herë për deputetin analfabet dhe “mbështetësit” e tij

CNA LIVESTREAM





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.